



Në bazë të nenit 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 46.1 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi Komunal i Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.30.11.2011, bie këtë:

V E N D I M

MBI FORMIMIN E KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

I.

Formohet Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale i Kuvendit Komunal të Deçanit, në këtë përbërje:

1. Bajram Kadriaj,
2. Enver Osdautaj,
3. Senaida Berisha,
4. Ramadan Tahiraj,
5. Hyri Dobrunaj.

Kryetarin e zgjedhin anëtarët e Komitetit nga radhët e veta në mbledhjen e parë.

II.

Funksionet dhe autorizimet e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale janë: Shqyrtimi i materialeve nga lëmia e shëndetësisë , nxjerrja e konkluzioneve për çështjet e shqyrtuara dhe dhënja e Rekomandimeve Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit.

III.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

IV.

Me Vendim paisen, të emruarit në pikën I. dhe Arhivi.

01.Nr.X-2

Deçan,dt.30.11.2011

KUVENDI KOMUNAL I DEÇANIT

K r y e s u e s i:
Jashar Dobraj